

NDIKIMI I PRANISË NDËRKOMBËTARE NË ZHVILLIMIN E DREJTËSISË PENALE NË KOSOVËN E PASLUFTËS: SFIDAT E BASHKËPUNIMIT (TË MUNGUAR) MES GJYQTARËVE VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË

* Gentian GURRA¹

Abstrakt:

Duke vlerësuar nevojën për funksionimin efikas dhe të paanshëm të drejtësisë penale në kontekstin historik të Kosovës së vitit 2000, nëpërmjet Rregullores së UNMIK-ut 2000/6, PSSP vendosi kooptimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë. Rregullorja parashikonte emërimin e këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë prej PSSP-së dhe “integrimin” e tyre në sistemin ekzistues gjyqësor. Rregullorja parashikonte që prokurorët ndërkombëtarë mund të zgjidhnin një rast të caktuar, zakonisht krime që cilësohen në çdo juridiksion si “të rënda”, bazuar në konsiderata ndaj karakterit ndër-etnik të krimit (i akuzuari i përket një etnie të ndryshme nga viktima), krime lufte apo krime të tjera të një karakteri të rëndë, ndjekja penale e të cilave nuk mund të ushtrohet prej prokurorëve vendorë për shkaqe që variojnë prej dyshimit të bazuar për mungesë paanshmërie deri në pamundësi objektive për shkaqe sigurie. Artikulli do të ndjekë një rrjedhë kronologjike të ngjarjeve relevante për të kulmuar me argumente që vënë në pikëpyetje dobishmërinë e sistemit ekzistues të drejtësisë penale “mikse” në dritën e zhvillimeve të pritshme politike në Kosovë.

Fjalët kyç: *Gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë, sistem penal miks, rritje e kapaciteteve vendore, bashkëpunim.*

* Gentian Gurra, Nëpunës juridik, IJSD/DoJ-UNMIK, 10 Gusht 2007. Opinione e shprehura në këtë artikull janë vetëm të autorit dhe nuk shprehin qëndrimin të organizatës për të cilën ai punon.